

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim  
(zgjidhjet)**

**P6**

Data 20/01/2018

## Detyra 1

Rezultatet operationale të Foto-Ing Shpk, një distributor i makinave të fotokopjes dhe skanerëve në tërë Kosovën, kanë qenë zhgënjyese. Rezultatet tregojnë një rënie të vazhdueshme në të hyra dhe fitime dhe rritje të borxheve të këqija.

Deri sa drejtorët e kompanisë janë të sigurt se linjat e produkteve të reja dhe inovative do të rrisin shitjet, ata nuk janë të sigurt nëse kontrollet e brendshme mbi shitjet dhe llogaritë e arkëtueshme i përmbushin objektivat e këtyre sistemeve. Prandaj ata kanë kërkuar nga firma juaj e auditimit të kryeni një rishikim të sistemit dhe të rekomandoni përmirësimet e përshtatshme.

Nga ekzaminimi i sistemit ekzistues të shitjeve dhe të llogarive të arkëtueshme, ju keni marrë informatat në vijim:

1. Ekipi i shitjes së kompanisë përbëhet nga katër menaxher të shitjes për katër zona të ndryshme të Kosovës (Prishtina, Peja, Gjilani dhe Prizreni) me pesë deri në tetë agjent të shitjes për secilën zonë. Secili nga agjentët e shitjes është i angazhuar në krijimin e shitjeve të reja dhe menaxhimin e llogarive të konsumatorëve, përfshirë ofrimin e të gjitha aspekteve të kontrollit të shitjeve me kredi.
2. Bonuset nga shitja që i paguhen agjentëve të shitjes bazohen në shitjet bruto të faturuara. Secili agjent i shitjeve ka autoritetin t'i ofrojë konsumatorëve deri në 30% zbritje nga çmimet standarde të autorizuara nga bordi i drejtorëve. Në fund të secilit muaj, menaxheri i shitjeve rishikon numrat e shitjeve nga agjentët bazuar nga faturat e lëshuara dhe pastaj e autorizon bonusin për secilin agjent përmes nëpunësit të pagave.
3. Shumica e shitjeve të reja gjenerohen përmes kontaktit me telefon ose përmes takimeve të realizuara nga agjentët. Agjentët e shitjes janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e pagesës dhe për ofrimin e kushteve për shitje me kredi para se të pranohen porositë e shitjeve. Për të ndihmuar në efikasitetin e këtij procesi, të gjithë agjentët e shitjes kanë marrë pjesë në trajnime për kontrollin e shitjeve me kredi nga kompania.
4. Kompania kërkon që të gjitha porositë e shitjeve të konfirmohen përmes emailit që i dërgohet nga konsumatori te agjenti i shitjes.
5. Pas pranimit të emailit, agjenti i shitjes:
  - Dërgon kopjen elektronike të porosisë te personeli i depoz dhe shton ndonjë mesazh qartësues nëse është e nevojshme. Ky email e aktivizon marrjen e porosisë nga stoqet e kompanisë që përbëhen nga afër 500 makina, e paketojnë porosinë dhe e dërgojnë te konsumatori së bashku me fletë-dërgesën. Një kopje e fletë-dërgesës mbahet në depo e cila pastaj përputhet me: a) kopjen e nënshkruar që kthehet nga konsumatori dhe b) një kopje të porosisë që është shkarkuar nga email.
  - Përgatit dhe dërgon faturën e shitjes te konsumatori duke përdorur format e paranumëruara që gjeneron sistemi. Detajet në faturë janë: data e faturës, referenca e shitjes, emri dhe adresa përfshirë adresën ku dërgohet, sasia dhe detajet e makinës, çmimi dhe konfirmimi i kushteve standarde për pagesë nga kompania. Një kopje e secilës faturë të lëshuar mbahet në zyrat e shitjes.
  - Dërgon me email një kopje të porosisë së konsumatorit dhe faturën e shitjes në departamentin e kontabilitetit të kompanisë. Pas pranimit të këtyre dokumenteve, departamenti i kontabilitetit: a) shkarkon kopjet e porosisë dhe faturës, b) menjëherë e

hap një llogari të konsumatorit të ri në librin e llogarive të arkëtueshme dhe c) e poston (regjistron) faturën e shitjes në sistemin e kontabilitetit. Faturat e postuara pastaj vendosen në dosje sipas numrit të njëpasnjëshëm të porosisë së shitjeve që janë dërguar me email.

**Kërkohe:**

(a) Diskutoni katër objektiva të kontrolleve të brendshme që duhet të ushtrohen mbi sistemin e shitjeve dhe llogarive të arkëtueshme. (5 pikë)

(b) Lidhur me kontrollet ekzistuese mbi shitjet dhe llogaritë e arkëtueshme dhe poashtu mbi pagesën e bonuseve nga kompania Foto-Ing, rishikoni procedurat duke:

(i) Vlerësuar pesë mangësi në sistem; dhe (10 pikë)

(ii) Rekomandoni përmirësimet për të adresuar këto mangësi. (5 pikë)

Mund të supozoni se ka personel të mjaftueshëm për të operuar kontrollet në mënyrë efektive.

**(Gjithsej 20 Pikë)**

## Zgjidhja

(a) Objektivat e sistemeve të shitjes dhe llogarive të arkëtueshme janë të sigurojnë se:

- (i) Porositë e konsumatorëve ekzekutohen shpejtë dhe me efikasitet.
  - (ii) Të gjitha mallrat dhe shërbimet e ofruara nga kompania faturohen.
  - (iii) Faturat e shitjes lëshohen me kohë.
  - (iv) Çmimet në faturat e shitjes janë të sakta.
  - (v) Konsumatorët kreditohen për kthime të autorizuara dhe për shërbime që përmbajnë gabime.
  - (vi) Transaksionet e shitjes regjistrohen më kohë, saktë dhe plotësisht në regjistrat kontabël të kompanisë.
  - (vii) Faturat paguhen në pajtueshmëri me kushtet e tregtimit të kompanisë.
  - (viii) Borxhet e këqija minimizohen
  - (ix) Ekziston një njohje e hershme e borxheve të këqija së bashku me regjistrim me kohë, të saktë dhe të plotë në regjistrat kontabël.
- (së paku pesë objektiva për 5 pikë)*

(b)

### (i) Dobësia

Agjentët e shitjes janë përgjegjës për të gjitha aspektet e kontrollit të shitjeve me kredi.

#### **Ndikimi i dobësisë**

Agjentët kanë një konflikt interesi në maksimizimin e shitjeve ndaj konsumatorëve deri sa janë përgjegjës për minimizimin e rrezikut nga borxhet e këqija. Problem rritet edhe më tutje nga fakti se agjentët e shitjes pranojnë bonuse bazuar në shifrat e shitjeve.

#### **Rekomandimi**

Agjentët e shitjes nuk duhet të jenë pjesë e funksionit të kontrollit të shitjeve me kresi. Ky funksion duhet të menaxhohet dhe kontrollohet nga një zyrtar përgjegjës të punësuar nga kompania (kontrollor i kredisë) dhe ky person duhet të jetë i pavarur nga funksionet e shitjes dhe kontabilitetit.

### (ii) Dobësia

Urdhërblertjet pranohen nga konsumatorët e mundshëm bazuar nga një konfirmim i thjeshtë me email.

#### **Ndikimi i dobësisë**

Ka një rrezik në rritje për mosmarrëveshje me konsumatorët për porositë e dërguara dhe humbjet pasuese nga kompania në të ardhmen. Po ashtu ka një rrezik që mallrat të dërgohen tek konsumatorët mashtrues.

#### **Rekomandimi**

Kompania duhet të ketë procedura të forta për të ndihmuar qartësinë dhe sigurinë e procesit të porosisë nga konsumatorët. Kjo procedurë duhet të kërkojë që të përcjellen porositë e detajuara dhe të autorizuara të shitjes ose në mënyrë elektronike ose të dërgohen në formë fizike në lokalet e kompanisë. Për porositë që janë jashtëzakonisht të mëdha, procedurat duhet të modifikohen për të siguruar se ka kontroll dhe autorizim nga menaxheri i shitjes si mjes i kontrollit shtesë, para se të pranohet porosia.

### (iii) Dobësia

Faturat përcjellen te konsumatorët pas pranimit të porosisë nga konsumatori.

#### **Ndikimi i dobësisë**

Ka një rrezik se të hyrat nga shitja mund të njihen gabimisht, para se mallrat të pranohen nga konsumatorës. Si rrjedhojë ka një rrezik të ngjashëm se fitimet e raportuara dot ë mbivlerësohen.

#### **Rekomandimi**

Faturat e shitjes duhe të dërgohen te konsumatorët vetëm pas konfirmimit të pranimit të mallrave nga ata. Për të ndihmuar në këtë proces, duhet të dërgohet një kopje e plotësuar e pranimit të mallit nga konsumatori nga depoja në departamentin e shitjes si bazë për faturim.

**(iv) Dobësia**

Bonuset e shitjes paguhen bazuar në faturat e lëshuara, faturat që janë lëshuar ende pa u konfirmuar pranimi i mallit nga konsumatorët.

**Ndikimi i dobësisë**

Ka një rrezik të madh që kompania paguan bonuse nga shitjet e pakompletuara.

**Rekomandimi**

Bonuset e shitjes duhet të paguhen bazuar në faturat që janë autorizuar nga menaxheri i shitjes pra pasi që faturimi është bërë pasi që ka dëshmi se malli është pranuar nga konsumatori. Për të pasur kontroll më të mirë, llogaritja e bonuseve duhet të bëhet në mënyrë të pavarur nga departamenti i shitjes dhe pastaj të autorizohen nga zyrtari përgjegjës. Vetëm pas autorizimit pagesa e bonuseve duhet të dërgohet në departamentin e pagave.

**(v) Dobësia**

Nuk ka kontrole të mjaftueshme lidhur me hapjen e llogarive të konsumatorëve të rinj në librin e llogarive të arkëtueshme.

**Ndikimi i dobësisë**

Ka rrezik se kompania do të ketë humbje si pasojë e borxheve të këqija nga konsumatorët fiktiv.

**Rekomandimi**

Duhet të ketë kontrole rigoroze mbi hapjen e llogarive të konsumatorëve. Këto kontrole duhet të përfshijnë kontrollimin e aftësisë së pagesës nga konsumatorët potencial, marrja e referencave nga kreditorët tjerë dhe përcaktimi i limiteve kreditore të duhura. Gjithashtu duhet të ketë kontrole strikte mbi mirëmbajtjen e dosjes kryesore të llogarive të arkëtueshme me ndarje të duhura të detyrave në mes të stafit të shitjes dhe kontabilitetit si dhe autorizimi i llogarive të reja të konsumatorëve të bëhet nga një përgjegjës i caktuar i kompanisë, për shembull drejtorit financiar ose kontabilisti kryesor.

**(vi) Dobësia**

Nuk ka gjurmë të duhur të auditimit në transaksionet e shitjes në departamentin e kontabilitetit. Të hyrat që kanë të bëjnë me transaksionet e shitjes duhet të njihen në momentin e dërgesës së makinës te konsumatori. Fletëdërgesa e nënshkruar duhet të përcjellet në kontabilitet. Aktualisht departamenti i kontabilitetit nuk njohet për datën e dërgesës.

**Ndikimi i dobësisë**

Ka rrezik se regjistrat e kontabilitetit mund të jetë të paplotë dhe të pasaktë sa i përket transaksioneve të shitjes.

**Rekomandimi**

Një kopje e nënshkruar e fletëdërgesës duhet të dërgohen në kontabiliteti dhe pastaj të përputhet me fletëporosinë e konsumatorit dhe kopjen e faturës. Stafi i kontabilitetit duhet të monitoroj në mënyrë të vazhdueshme numrat e njëpasnjëshme të fletëdërgesave dhe faturave të pranuar dhe të procesuara, për të siguruar se transaksionet e shitjes janë përpunuar në mënyrë të plotë.

**(vii) Dobësia**

Transaksionet e faturave të shijes në kompani regjistrohen pa një autorizim të mëparshëm nga personi përgjegjës i kompanisë.

**Ndikimi i dobësisë**

Mund të regjistrohen transaksione të pautorizuara në regjistrat e kontabilitetit që mund të rezultojnë me raportim të pasaktë financiar, mosmarrëveshje të panevojshme me konsumatorët dhe humbje të zërit të mirë të kompanisë.

**Rekomandimi**

Stadfi i kontabilitetit duhet të përputh kopjet e autorizuara të faturave të shitjes me fletëdërgesa dhe me fletëporosi dhe ti dërgoj ato te zyrtari i autorizuar (psh drejtori financiar) për të kontrolluar dhe autorizuar para se të postohen ne regjistrat e kontabilitetit të kompanisë.

## **Detyra 2**

Ju jeni senior i auditimit për kompaninë Giza Shpk, një shitës me pakicë i veshjeve dhe aksesorëve. Pikët në vijim shpjegojnë aspektet e ndryshme të aktiviteteve të kompanisë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017:

- Kompania tregton përmes 12 dyqaneve të shtrira në të gjithë vendin.
- Dy nga dyqanet realizojnë 29% dhe 22% përkatësisht të qarkullimit total të kompanisë prej €10 milion.
- Kompania është themeluar 20 vjet më parë dhe ka arritur një rritje stabile me një strategji të marketingut që përfshinte brendimin e produkteve me cilësi të lartë dhe çmime të larta. Giza Shpk mban nivele të larta të stoqeve dhe për shkak të ndryshimit konstant të modës, shpesh shet produkte me çmim më të ulët se kosto.
- Drejtorët e kompanisë janë shumë të interesuar të kenë raportim të shpejtë të shitjeve dhe informatave tjera financiare dhe insistojnë që të përgatiten pasqyrat menaxheriale mujore brenda 8 ditësh pas përfundimit të muajit. Ngjashëm, ata gjithmonë insistojnë që auditimi i pasqyrave financiare të kompanisë të përfundoj brenda 12 javësh pas përfundimit të vitit kalendarik/fiskal.
- Gjatë muajit maj 2017, për të ndihmuar në raportim dhe përgatitje të shpejtë të pasqyrave menaxheriale, kompania ka investuar në sistem të centralizuar kompjuterik që është i lidhur direkt me të gjitha arkat në secilin dyqan.

### **Kërkohet:**

(a) Identifikoni tri përfitime që ka planifikimi i auditimit në auditimin e pasqyrave financiare.

(3 pikë)

(b) Për secilin nga pesë aspektet e aktiviteteve të mësipërme, analizoni se si do të ndikojnë në strategjinë e auditimit të pasqyrave financiare të kompanisë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017. (15 pikë)

(c) Përmbledhni shkurtimisht se si do të ju ndihmojnë rezultatet e procedurave analitike në fazën e vlerësimit të rrezikut në auditim, për të planifikuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të mëtuqjeshme të auditimit. (2 pikë)

**(Gjithsej 20 Pikë)**

## Zgjidhja

(a) Përfitimet nga planifikimi i duhur i auditimit të pasqyrave financiare:

- Ndhmon auditorin të përkushtojë vëmendje të duhur fushave të rëndësishme të auditimit.
  - Ndhmon auditorin të identifikoj dhe zgjidhë problemet e mundshme me kohë.
  - Ndhmon auditorin të organizoj dhe menaxhoj angazhimin e auditimit në mënyrë që të kryhet në mënyrë efektive dhe efikase.
  - Ndhmon në përzgjedhjen e ekipit të angazhimit me nivele të duhura të aftësisë dhe kompetencave për t'iu përgjigjur rrezikut të parashikuar dhe përcaktimin e duhur të punës për secilin.
  - Ndhmon drejtimin dhe mbikqyrjen e ekipit të auditimit dhe rishikimin e punës së tyre.
  - Ndhmon, aty ku është e aplikueshme, në koordinimin e punës së kryer nga ekspertët.
- (Pikët e plota për theksimin e së paku 3 përfitimeve më sipër)*

(b) Aspektet të cilat ndikojnë në strategjinë e auditimit:

Numri i dyqaneve dhe lokacioneve të tyre

Duhet të konsiderohet fakti se aktivitetet e kompanisë kryhen nga një rrjet i dyqaneve të shpërndara në tërë zonën gjeografike. Auditimi duhet të siguroj se testimi është përfaqësues i aktiviteteve në të gjitha dyqanet. Auditorët e kompanisë mund të kenë adaptuar më parë një strategji për të siguruar se të gjitha dyqanet vizitohen nga stafi i auditimit, në bazë të rrotacionit brenda periudhës disa vjeçare. Mirëpo, për të kufizuar rrezikun e auditimit në një nivel të pranueshëm, duhet të vendoset theks i duhur në nivelin e aktivitetit dhe rrethanat specifike në secilin dyqan në baza vjetore para se të vendoset cilat dyqane të vizitohen për të kryer testimet e duhura të auditimit. Detyrat siç janë numërimi i stoqeve, numërimi i parasë, auditimi i stoqeve në transit, të gjitha këto duhet të konsiderohen. Ekzistenca e një rrjeti të dyqaneve dhe kërkesa për të vizituar dyqanet do të ketë ndikim të konsiderueshëm në nevojën për personel të auditimit, logjistikë, komunikim, drejtim dhe mbikqyre të punës së auditimit. Secila nga këto çështje duhet të konsiderohet me kujdes gjatë zhvillimit të strategjisë së auditimit.

Ekzistenca e dy dyqaneve me performancë më të lartë

Strategjia e auditimit duhet të reflektoj faktin se secila nga dy dyqanet marrin pjesë me përqindje më të lartë të të hyrave totale të kompanisë. Prandaj, duhet të alokohen burime të përshtatshme të auditimit në vlerësimin e aktiviteteve të kontrollit dhe të kryhen teste të përshtatshme të auditimit në këto dy dyqane.

Strategjia e marketingut të kompanisë

Fakti se kompania shpesh shet produkte me çmim më të ulët se kosto për shkak të strategjisë së marketingut të saj e rrit rrezikun e vetëvetishëm që shoqërohet me auditimin e stoqeve të kompanisë. Implikimi evident është se stoqet mund të mbivlerësohen për shkak të lejimit që mund të mos jetë regjistruar në libra për shkak të rënies së vlerës së stoqeve. Nëse ka mbivlerësim të stoqeve, atëherë ky do të ishte shqetësim i veçantë i auditorit të kompanisë. Strategjia e auditimit duhet të adresoj këtë çështje duke siguruar se janë marrë parasysh stoqet dhe vlerësimi i tyre.

Orari i raportimit me pasqyra financiare të audituara

Për të siguruar se është përmbushur kërkesa 12 javëshe për raportim pas fundit të vitit, është me rëndësi që puna e auditimit të kryhet me kohë. Prandaj auditori duhet të sigurohet se në këtë angazhim ka burime të mjaftueshme, logjistika dhe kryerja e procedurave është organizuar si duhet. Gjithashtu auditori duhet të sigurohet se është bërë komunikimi i duhur dhe me kohë me menaxhmentin e kompanisë si pjesë e mirë koordinuar e strategjisë së auditimit.



Implementimi i sistemit të ri të kompjuterizuar të kontabilitetit

Implementimi i sistemit të ri të kontabilitetit gjatë vitit do të ketë ndikim të madh në punën e auditimit. Auditorët duhet të vlerësojnë rrezikun e pasqyrave financiare si rezultat i implementimit të sistemit të ri. Strategjia e auditimit duhet të siguroj se i është vendosur theks i duhur kësaj çështjeje dhe se janë ndarë burime të duhura për të vlerësuar rrezikun dhe për të kryer procedurat e nevojshme të pavarura të auditimit.

(c) Në fazën e vlerësimit të rrezikut ju tashmë keni identifikuar fushat me rrezik në pasqyrat financiare të kompanisë që mund të jetë rrezik i anomalisë materiale për shkak të gabimit ose mashtrimit. Rezultatet e procedurave të auditimit mund të kenë identifikuar ekzistencën e transaksioneve ose ngjarjeve të pazakonshme, të shumave, koeficientëve dhe trendeve që mund të tregojnë për çështjet që kanë ndikim mbi auditimin.

### Detyra 3

'Hipoteza e vijimësisë' është njëra nga parimet kyçe mbi të cilat bazohen pasqyrat financiare.

#### Kërkohet:

(a) Përgatitni një memo në të cilën diskutoni detajet në vijim:

- (i) Përgjegjësitë e drejtorëve dhe auditorëve lidhur me hipotezën e vijimësisë. Përgjigja juaj duhet të përfshijë hapat themelor që kërkohen sipas *SNA 570 – Hipoteza e vijimësisë*. (4 pikë)
- (ii) Tri ngjarje financiare dhe tri ngjarje operacionale të cilat mund të ndikojnë në hipotezën e vijimësisë. (9 pikë)

(b) Gjatë auditimit keni vërejtur se ekziston një ngjarje pasuese e cila mund të rezultoj që kompania të mos operojë sipas hipotezës së vijimësisë. Çfarë lloji të opinionit të auditimit do të jepnit:

- (i) Nëse është bërë shpalosje e plotë e ngjarjes dhe rezultatit të mundshëm të ngjarjes në pasqyrat financiare?
- (ii) Nëse nuk është bërë shpalosje e ngjarjes dhe rezultatit të mundshëm të ngjarjes në pasqyrat financiare? (3 pikë)

(c) Pohimi i plotësisë është gjithmonë më i vështirë për tu vlerësuar nga auditori, veçanërisht lidhur me provizionet dhe detyrimet kontingjente. Shpjegoni katër hapa që duhet të ndërmerr auditori për të zbuluar detyrimet e paregjistruara. (4 pikë)

**(Gjithsej 20 Pikë)**

## Zgjidhja

### (a)

#### (i) Përgjegjësitë e drejtorëve dhe auditorëve për hipotezën e vijimësisë

- Përgjegjësia primare për vlerësimin e përshtatshmërisë së hipotezës së vijimësisë është e menaxhmentit të kompanisë.
- Nëse pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e hipotezës së vijimësisë, auditorët duhet të konsiderojnë dhe vlerësojnë nëse zbatimi i kësaj baze është i përshtatshëm duke i matur zërat që paraqiten në pasqyrat financiare.
- SNA 570 Hipoteza e Vijimësisë kërkon nga auditorët që gjatë planifikimit të auditimit, të identifikojnë rreziqet që mund të shkaktojnë pasiguri materiale lidhur me aftësinë e kompanisë të vazhdojë me aktivitetet e saj sipas hipotezës së vijimësisë. Prandaj auditori duhet të përfshij procedurën të përshtatshme në programet e auditimit.
- Auditori do të vlerësojë vlerësimin e bërë nga menaxhmenti për aftësinë e entitetit për të vazhduar sipas hipotezës së vijimësisë dhe të jetë i kujdesshëm nëse ka ngjarje ose kushte të cilat mund të hedhin dyshim mbi këtë hipotezë.

#### (ii) Ngjarjet financiare dhe operacionale që ndikojnë në hipotezën e vijimësisë

##### Financiare

Entiteti nuk ka përmbushur marrëveshjet për huazim/kredi

Ka tregues se është tërhequr mbështetja financiare nga debitorët dhe kreditorët e kompanisë

Entiteti ka rrejdhe negative të parasë, që tregohet përmes pasqyrave financiare historike ose të ardhshme

Entiteti është i paaftë të paguajë me kohë kreditorët/të pagueshmet

Entiteti ka shitur pasuri domethënëse joqarkulluese dhe nuk ka qëllim të zëvendësojë ato pasuri

Entiteti nuk është në pajtueshmëri me kërkesat kapitale ose ligjore psh bankat

Ndryshimet legjislative mund të kenë ndikim mbi entitetin

Paaftësia për të financuar produktet e reja ose zhvillimin e produkteve

##### Operacionale

- Humbja e menaxhmentit ose pesonelit kyç

Vështrësi në gjetjen e punëtorëve

Mungesë e furnizimeve kyçe

Humbja e një tregu të madh

Ndryshime fundamentale në treg, psh teknologji e re ndaj të cilës kompania nuk mund ti përgjigjet

Varëshmëri e tepruar vetëm në disa produkte kur ka rënie të tregut

### (b)

(i) Nëse ka shpalosje të plotë – auditori jap një opinion të pakualifikuar duke përfshirë një paragraf të theksimit të çshtjes në seksionin e bazës për opinion.

(ii) Nëse entiteti refuzon të bëjë shpalosjet e duhura – auditori jap një opinion të kualifikuar me 'përveç për', për shkak të mosmarrëveshjes për mjaftueshmërinë e shpalosjeve.

### (c) Detyrimet e paregjistruara

- Rishikimi i ngjarjeve pas datës së raportimit deri në datën e aprovimit të pasqyrave financiare
- Bisedat dhe pyetjet me menaxhmentin
- Bisedat dhe pyetjet me këshilltarët ligjor/avokatët e entitetit për mundësinë e ndonjë detyrimi të paregjistruar

- Rishikimi i procesverbalëve të takimeve të bordit dhe menaxhmentit
- Rishikimi i kontratave dhe marrëveshjeve për kredi
- Rishikimi i konfirmimeve të shkruara nga avokatët e kompanisë si dëshmi për ndonjë detyrim të pritshëm kontingjent ose padi
- Rishikimi i urdhërblërjeve të hapura
- Rishikimi i librit të bankës dhe blerjeve pas datës së raportimit për transaksionet që do të duhej të trajtoheshin në periudhën e mëparshme.

#### Detyra 4

BauKos Shpk është një kompani që merret me shitjen e mjeteve të punës me shitore të shtrira në tërë Kosovën. Kompania punëson 85 punëtorë, disa prej të cilëve paguhen me orë. Ekziston një departament i madh i administratës dhe kontabilitetit me ndarje të duhur të detyrave, kontrolle mbikqyrëse dhe nivele të duhura të autorizimit në funksione të ndryshme të kontabilitetit. Firma juaj është auditore e kompanisë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017 dhe së bashku me një asistent të auditimit pa përvojë ju jeni caktuar të auditoni pagat.

Kompania paguan punonjësit në baza javore duke përdorur një sistem të kompjuterizuar të pagave, para se pagat të transferohen në llogarit bankare të punonjësve. Shpenzimet e pagave në pasqyrat financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 janë raportuar gjithsejt €1.45 milion.

Ju jeni duke planifikuar të filloni me testet e kontrollit në sistemin e pagave. Mirëpo nga diskutimet me asistentin e auditimit, keni kuptuar se ai nuk e kupton konceptin e përfuturit të dëshmive të auditimit për të verifikuar pohimet në pasqyrat financiare. Ai gjithashtu nuk kupton disa metoda të njohura të përzgjedhjes së mostrës që do të testohen nga popullata.

#### Kërkohe:

(a) Shpjegoni pohimet kyçe të të bëra nga menaxhmenti lidhur me shifrën prej €1.45 milion të shpenzimeve të pagave në pasqyrat financiare. (5 pikë)

(b) Shpjegoni termat në vijim që zbatohen në metodat e mostrimit në auditim sipas *SNA 530*

*Mostrimi në auditim:*

(i) Përzgjedhja e rastësishme; (2 pikë)

(ii) Përzgjedhja në mënyrë të çrregullt (kuturu); (2 pikë)

(iii) Përzgjedhja sistematike. (2 pikë)

(c) Numëroni dhe shpjegoni testet e kontrolleve që duhet të kryhen lidhur me auditimin e pagave në rastin e kompanisë BauKos Shpk për vitin deri me 31 dhjetor 2017. (9 pikë)

**(Gjithsej 20 Pikë)**

## Zgjidhja

(a) Me rastin e raportimi të pagave prej €1.45 milion në pasqyrat financiare të kompanisë, drejtorët e kompanisë bëjnë këto pohime:

- (i) kostot e raportuara prej €1.45 milion kanë ndodhur si duhet dhe kanë të bëjnë me kompaninë
- (ii) kostot e raportuara prej €1.45 milion janë të plota dhe nuk ka pasur paga që kanë ndodhur për vitin që përfundoi me datën 31 dhjetor 2017
- (iii) kostot e raportuara prej €1.45 milion saktësisht relektojnë koston totale të pagave për kompaninë për vitin që përfundoi me datën 31 dhjetor 2017
- (iv) kostot e raportuara prej €1.45 milion kanë të bëjnë vetëm me kostot e ndodhura brenda këtij viti
- (v) kostot e raportuara prej €1.45 milion janë klasifikuar si duhet si kosto e pagave

(Së paku 4 pika të mësipërme duhet të përmende për 5 pikë)

(b)

(i) Përzgjedhja e rrestësishme

Sipas kësaj metode të përzgjedhjes të gjitha elementet në popullatë kanë rastin e njëjtë statistikor të përzgjedhjes në mostër. Kjo metodë përdoret numra të rastësishëm për përzgjedhjen e elementeve në mostër.

(ii) Përzgjedhja e çregullt (kuturu)

Sipas kësaj metode auditori përpiket të siguroj se të gjitha elementet në popullatë kanë mundësin e përzgjedhjes në mostër. Auditori përzgjedh elementet në mostër duke mos ndjekur ndonjë teknikë të strukturuar. Edhe pse nuk përdoret ndonjë teknikë e strukturuar, auditori duhet të eliminojë ndonjë bazë të vetëdijshme për të përzgjedhur elementet në mostër (psh shmangia e zgjedhjes së elementeve që është vështirë të merren ose gjithmonë përzgjedhja ose shmangia e elementeve nga faqja e parë). Kjo metodë nuk është e përshtatshme kur përdoret mostrimi statistikor. (2 marks)

(iii) Përzgjedhja sistematike

Kjo është metodë e përzgjedhjes në të cilin auditori përdor një interval constant në mes të përzgjedhjeve. Elementi i parë në mostër përzgjedhet duke përdorur numër të rastësishëm dhe pastaj intervali i mostrës gjenerohet nga auditori, për shembull duke pjesëtuar popullatën me madhësinë e mostrës.

(c) Testet e kontrollit në vijim mund të kryhen në lidhje me verifikimin e kostos së pagave të kompanisë BauKos:

- (i) rishikimi i një mostre të dosjes së të punësuarve për të verifikuar se të gjithë fillestarët, të larguarit dhe të punësuarit që kanë ndryshime gjatë vitit janë të autorizuar nga personi i duhur përgjegjës
- (ii) kontrollo të dhënat nga dosja kryesore e pagave për të tesuar që të gjitha ndryshimet janë autorizuar nga personi përgjegjës
- (iii) ekzamino një mostër të kartelave kohore të të punësuarve për të siguruar se janë autorizuar nga personi përgjegjës
- (iv) verifiko nëse procedurat e përgatitjes, ndryshimit në paga etj janë të kryera nga persona të ndryshëm - ndarje e duhur e detyrave
- (v) testo saktësinë e llogaritjes së pagave
- (vi) testo trajtimin e duhur të zbritjeve ligjore nga pagat
- (vii) rishiko një mostër nga lista e pagave për dëshmi të autorizimit para postimit në kontabilitet
- (ix) gjurmo një mostër të pagesave neto që janë transferuar te punonjësit për tu siguruar se është bërë pagesa me kohë e detyrimeve

## Detyra 5

Firma e auditimit Koni & Partnerët e cila ka një numër të klientëve të listuar në bursë para disa ditësh kishte një sesion të trajnimeve lidhur me kontrollin e cilësisë. Para përfundimit të trajnimit u diskutuan disa çështje që kanë të bëjnë me kodin e etikës. Secila ngjarje është e veçantë:

(a) Menjëherë pas fillimit të auditimit të një klienti të listuar, një anëtar junior i ekipit të auditimit trashëgoj një numër domethënës të aksioneve të kompanisë klient. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga firma e auditimit lidhur me këtë rast edhe pse aksionet e trashëguara nga anëtari ishin investim domethënës për të mirëpo kishin shumë jomateriale për kompaninë e audituar. Përveç kësaj, partneri i angazhimit e dinte se pasi që rezultatet e kompanisë do të shpallehin do të kishte rritje të çmimit për aksion prandaj mendonte se nuk ishte e drejtë ndaj antëtarit junior të ekipit të kërkonte ti shiste aksionet para shpalljes së rezultateve. (5 pikë)

(b) Kontabilisti i një klienti tjetër të listuar pati një aksident dhe nuk kishte shkuar në punë për tre muaj. Në kohën e aksidentit, seniori i auditimit ishte duke përmbledhur punën e auditimit të vitit të kaluar. Pasi që ai kishte njohuri në sistemet e kontabilitetit të klientit, ishin pajtuar me firmën që ai të zëvendësonte kontabilistin e kompanisë për ato 3 muaj. (5 pikë)

(c) Në letrën e menaxhmentit që Koni dërgoi te një kompani klienti kishte treguar se sistemi i tyre i kompjuterizuar kishte mangësi në kontrollet kyçe. Pas kësaj, kompania vendosi të instaloj një sistem të ri për të cilin ishte përfshirë departamenti i konsulencës së firmës Koni për të dizenuar këtë sistem. (5 pikë)

(d) Firmës Koni & Partnerët ishte afruar një kompani e madhe e cila nuk ishte atëherë klient i tyre për opinion të dytë të auditimit. Kompania ishte në mosmarrëveshje me auditorët e saj eksitues të cilët kishin propozuar një opinion të kualifikuar (me rezervë) për shkak të mosmarrëveshjes lidhur me vlerësimin e stoqeve. Partneri teknik e rishikoj evidencën e auditimit të ofruar nga kompania dhe e këshilloj kompaninë se trajtimi i tyre kontabël për stoqet ishte në rregull. Menjëherë pas kësaj, firma Koni & Partnerët u ftua të bëhet auditor i kompanisë. Në letrën e komunikimit me auditorin e mëparshëm, auditori ekzistues u përgjigj se mosmarrëveshja lidhur me trajtimin e stoqeve nuk ishte aq e thjeshtë siç pretendonte kompania. (5 pikë)

### **Kërkohet:**

Vlerësoni duke diskutuar nëse firma e auditimit Koni & Partnerët është në pajtueshmëri me parimet e kodit të etikës ose nëse ka vepruar në mënyrë joprofesionale në rastet e mësipërme.

**(Gjithsej 20 Pikë)**

## Zgjidhja

### (a) Trashëgimia e aksioneve

Për derisa partnerët nuk janë të lejuar të mbajnë aksione të klientëve të auditimit ndonjëherë është e paqartë nëse kjo zbatohet edhe te anëtarët junior të ekipit të auditimit të cilët mund të mos kenë përgjegjësi për auditimin. Shumë firma dhe rrjete të firmave të auditimit kanë zbatuar rregulla strikte lidhur me mbajtjen e aksioneve nga të gjithë të punësuarit e tyre. Në anën tjetër, vlera e aksioneve të mbajtura nga anëtari është jomateriale për kompaninë, mirëpo është materiale për anëtarin dhe kjo mund të çojë në ndryshim të sjelljes së anëtarit junior ndaj auditimit duke mos ushtruar gjykimin dhe skepticizmin në nivel të duhur. Nëse anëtari junior lejohet të mbajë aksionet e kompanisë klient për shkak se partneri i auditimit ka pasur njohuri se çmimi i aksioneve do të rritet, atëherë kjo është joetike dhe është tregtim me informata të brendshme sepse përdoren informatat e privileguara nga klienti për avantazh personal.

### (b) Shërbimet e kontabilitetit

Përgatitja e regjistrave kontabël në emër të një kompanie që është e listuar në bursë, është e ndaluar. Gjithashtu angazhimi i një stafi të auditimit në rolin senior siç është kontabilisti i kompanisë, ka gjasë të madhe të kërcënojë pavarësinë e firmës së auditimit. Personeli i auditimit në këtë rast do të ishte i punësuar në emër të klientit dhe firma e auditimit do të raportonte mbi performancën financiare në të cilën një i punësuar i tyre kishte luajtur rol aktiv. Përdoruesit e pasqyrave financiare do të arrinin në përfundim se firma e auditimit ka pasur motivim të fshehtë performancën e dobët për shkak të veprimeve të personelit të tyre.

### (c) Këshillat mbi kontrollet

Kjo është një çështje kundërtënëse sa i përket pavarësisë së auditorit. Për derisa raportimi mbi dobësitë në kontrolle mund të zbulohen gjatë auditimit është kërkesë nga procedurat e auditimit, këshillimi lidhur me zhvillimin e një sistemi të ri për të kapërcyer ato dobësi nga disa kritik shihet si kërcënim i mundshëm ndaj pavarësisë. Ka çështje specifike dhe të përgjithshme. Çështja e përgjithshme është se firma e auditimit gjeneron të hyra nga punët e auditimit dhe jo të auditimit. Gjatë kryerjes së auditimit auditorët mund të ngurrojnë të mos pajtohen me menaxhmentin nga frika për mos të humbur punën. Megjithatë, kontratat për punën joaudituese jepen nga menaxhmenti. Qështja specifike është kërcënim i vetërishtimit. Nëse firma e auditimit përfshihet në disenjimin e sisteme të kontrollit, kur ata auditojnë ato sisteme mundën qëllimisht mos të identifikojnë dobësi në sistemin e punuar nga vetë ata. Për derisa ofrimi i punëve joaudituese nuk ndalohet, firmat duhet të sigurohen se tarifat e pranuar nga një klient i vetëm nuk mund të tejkalojnë 10% (të listuar) -15% (të palistuar) të të hyrave të përgjithshme. Mirëpo kodi i etikës kërkon që auditori nuk duhet të merr vendime menaxheriale.

### (d) Këshilla ndaj klientëve që nuk u ofrohet auditim

Edhe pse firma e auditimit nuk ka kërcënim të pavarësisë, veprimet e tyre mund të shkelin rregullat profesionale. Duke i ofruar këshilla ata janë duke paragjykuar në pavarësinë e auditorëve të kompanisë të cilës i ofrojnë këshilla. Kjo praktikë ndonjëherë njihet si 'pazari për opinione' dhe përdoret nga kompanitë për të ushtruar presion ndaj auditorëve ekzistues. Me rastin e kërkesës për ofrimin e këshillave, firma Koni & Partnerët do të duhej të komunikonin me auditorët ekzistues për tu siguruar se këshilla e tyre bazohet në të gjitha faktet e disponueshme. Koni ka përgjegjësi etike të refuzojë emërimin si auditor dhe të tërheqë këshillën që ia ka dhënë më herët kompanisë.